

RAPORT VJETOR



PATRULLA E PUTRAVE

“ATO NUK KANË ZË, POR TI KE NDËRGJEGJE.”

MAHIR DOMI, ELBASAN



PËRMBAJTJA

- 01 Përshkrim i kompanisë
- 02 Vizioni & Misioni
- 03 Struktura e departamenteve
- 04 Problemi, Zgjidhja, Klienti
- 05 Produkti
- 06 Marketing & Shitje
- 07 Pasqyra financiare
- 08 Përmbledhje

PËRSHKRIM I KOMPANISË

“Patrulla e Putrave” është një ndërmarrje sociale e krijuar dhe e menaxhuar nga nxënësit, me fokus në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për kafshët shtëpiake, si dhe ndihmën ndaj kafshëve të braktisura në qytetin e Elbasanit.

Kompania operon si një qendër shërbimesh për kafshë shtëpiake dhe endacake duke përfshirë:

- Shëtitje për kafshët
- Kujdes bazë higjienik
- Dyqan kafshësh për të shitur produkte artizanale
- Fushata ndërgjegjësimi për adoptimin e kafshëve
- Klinikë të vogël veterinare
- Minibar



VIZIONI & MISIONI



Vizioni i kompanisë “Patrulla e Putrave” është të shndërrohet në një model të qëndrueshëm të ndërmarrjes sociale në qytetin e Elbasanit, duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së kafshëve dhe në ndërtimin e një komuniteti më të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm ndaj tyre.

Misioni ynë është të ofrojmë shërbime dhe produkte cilësore për kafshët shtëpiake, ndërkohë që përdorim të ardhurat për të mbështetur kafshët në nevojë, duke promovuar adoptimin dhe duke rritur ndërgjegjësimin në komunitet.

VLERAT E KOMPANISË

- Përgjegjësia sociale – Angazhohemi për të ndihmuar kafshët në nevojë
- Kujdesi dhe humanizmi – Trajtojmë çdo kafshë me respekt dhe dashuri
- Profesionalizmi – Ofrojmë shërbime cilësore dhe të besueshme
- Bashkëpunimi – Punojmë si ekip dhe me komunitetin
- Qëndrueshmëria – Synojmë zhvillim afatgjatë dhe ndikim pozitiv

STRUKTURA E DEPARTAMENTEVE



Fabjon Gurra

President (CEO)

Drejton kompaninë dhe merr vendimet kryesore strategjike.



Ana Veliu

Departamenti i marketingut

Promovon produktet dhe tërheq klientë përmes fushatave dhe rrjeteve sociale.



Uendi Terolli

Departamenti i financës


Menaxhon të ardhurat, shpenzimet dhe buxhetin e kompanisë.



Danjela Dushku

Departamenti i prodhimit

Krijon dhe siguron cilësinë e produkteve artizanale.



Valdete Kadriu

Departamenti i marrëdhënieve me publikun

Komunikon me komunitetin dhe ndërton imazhin e kompanisë.

PROBLEMI

Në qytetin e Elbasanit ka një numër të lartë kafshësh të braktisura dhe mungesë shërbimesh të organizuara për kujdesin ndaj tyre.

ZGJIDHJA

“Patrulla e Putrave” ofron shërbime për kafshë shtëpiake, produkte artizanale dhe nisma për adoptim, duke përdorur të ardhurat për mbështetjen e kafshëve në nevojë.

KLIENTËT

Klientët tanë janë pronarët e kafshëve shtëpiake, familjet e interesuara për adoptim dhe komuniteti që mbështet nismat sociale për kafshët.

PRODUKTI

“Patrulla e Putrave” ofron një kombinim unik të produkteve dhe shërbimeve për kafshë shtëpiake, duke u fokusuar në cilësi, kujdes dhe ndikim social.

Produktet tona përfshijnë:

- Qafore të personalizuarra për qen dhe mace
- Lodra për kafshë
- Shtëpiza të vogla dhe aksesore të tjerë
- Produkte ekologjike dhe të sigurta për kafshët
-


Çdo produkt është:

- i sigurt për përdorim
- me kosto të përballueshme
- me qëllim mbështetjeje për kafshët e braktisura

Shërbimet kryesore

Përveç produkteve, kompania ofron edhe shërbime praktike:

- Shëtitje për qen
- Kujdes higjienik bazë
- Ushqyerje dhe mbikëqyrje për kafshët
- Konsulencë për adoptim



MARKETING & SHITJE



Modeli i biznesit

- B2C (Business to Consumer) – shërbime dhe produkte për individë (pronarë kafshësh)
- Ndërmarrje sociale me fokus fitimin dhe ndikimin komunitar
- Ri-investim i fitimeve në kujdesin për kafshët e braktisura

Strategjia e marketingut

- Marketing dixhital (përmes rrjeteve sociale)
- Marketing komunitar (aktivitete sensibilizuese dhe evente)
- Bashkëpunim me organizata



Strategjia e shitjes

- Shitje direkte të produkteve
- Promocione dhe oferta
- Shitje përmes rrjeteve sociale
- Ri-investim i fitimeve në projektet sociale

PASQYRA FINANCIARE

PRODUKTET DHE KOMISIONET

Produkti për kafshë	Çmimi i shitjes	Komisioni ynë	Fitimi për copë
Ushqim për qen (3kg)	1,200 lekë	20%	240 lekë
Ushqim për mace (2kg)	900 lekë	18%	162 lekë
Shampo për kafshë	700 lekë	25%	175 lekë
Aksesor (rrip, lodra)	500 lekë	30%	150 lekë

FITIMI

Përshkrimi	Shuma (lekë)
Fitimi bruto	48,170
(-) Kosto fikse	(41,000)
(-) Kosto variabël	(10,000)
FITIMI NETO	-2,830 (HUMBJE)

AKTIVET

Zëri	Shuma (lekë)
Cash	25,000
Llogari të arkëtueshme	7,000
TOTAL AKTIVE	32,000

SHPENZIMET (KOSTOT)

KOSTOT VARIABËL

Kategoria	Shuma (lekë)
Transport	5,000
Paketim	2,000
Evente / terren	3,000
TOTAL	10,000

KOSTOT FIKSE

Kategoria	Shuma (lekë)
Qira dyqani	15,000
Energji + ujë	3,000
Internet	1,000
Marketing bazë	2,000
TOTAL	21,000

NUMRI I AKSIONEVE


Përshkrimi	Vlera
Kapital total	35,000 lekë
Numri i aksioneve	50
Vlera për aksion	700 lekë

KAPITALI

Zëri	Shuma (lekë)
Kapital neto	35,000
TOTAL KAPITALI	35,000

PËRMBLEDHJE

“Patrulla e Putrave” përfaqëson një ndërmarrje sociale që kombinon sipërmarrjen me përgjegjësinë ndaj komunitetit, duke ofruar shërbime dhe produkte për kafshë shtëpiake, ndërkohë që kontribuon në përmirësimin e jetës së kafshëve të braktisura në qytetin e Elbasanit. Përmes një modeli biznesi të qëndrueshëm B2C, strategjive efektive të marketingut dhe një menaxhimi të kujdesshëm financiar, kompania ka arritur të gjenerojë të ardhura dhe të krijojë ndikim real social. Ky raport pasqyron jo vetëm rezultatet financiare dhe operacionale, por edhe angazhimin tonë për të ndërtuar një komunitet më të ndërgjegjshëm dhe human. Në të ardhmen, synimi ynë është zgjerimi i aktivitetit dhe realizimi i projektit për krijimin e një strehe të dedikuar për kafshët e braktisura, duke vazhduar kështu misionin tonë për të sjellë ndryshim pozitiv në shoqëri.



LETRA E PRESIDENTIT

Të nderuar aksionerë,

Me shumë kënaqësi ju prezantoj raportin vjetor të kompanisë sonë “Patrulla e Putrave”.

Ky vit ka qenë një eksperiencë e rëndësishme për ne si nxënës dhe si ekip. Ne kemi arritur të ndërtojmë një ndërmarrje sociale, që jo vetëm ofron shërbime dhe produkte për kafshë shtëpiake, por edhe kontribuon në ndihmën ndaj kafshëve të braktisura në qytetin tonë.

Gjatë këtij rrugëtimi kemi zhvilluar aftësi në punë në grup, menaxhim, komunikim dhe sipërmarrje. Kemi organizuar aktivitete ndërgjegjësuese dhe kemi kontribuar në përmirësimin e situatës së kafshëve në komunitet.

Pavarësisht sfidave, kemi arritur të realizojmë qëllimet tona dhe të krijojmë një ndikim pozitiv. Ne besojmë se kjo është vetëm fillimi dhe synojmë që në të ardhmen të zgjerojmë aktivitetin tonë dhe të realizojmë projektin për ndërtimin e një strehe për kafshët e braktisura.

Faleminderit të gjithë atyre që na kanë mbështetur gjatë këtij rrugëtimi.

Me respekt,

President i kompanisë

Fabjon Gurra.

STATUTI I SHOQËRISË

Neni 1 – Emërtimi

Shoqëria mban emrin “Patrulla e Putrave”.

Neni 2 – Forma ligjore

Shoqëria është e organizuar si një ndërmarrje sociale e drejtuar nga nxënësit, që operon në fushën e shërbimeve dhe produkteve për kafshë shtëpiake, me fokus në ndikimin social.

Neni 3 – Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në qytetin e Elbasanit, Republikën e Shqipërisë.

Neni 4 – Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Ofrimi i shërbimeve për kafshë shtëpiake (shëtitje, kujdes higjienik)
- Prodhimi dhe shitja e produkteve artizanale për kafshë (qafore, lodra, shtëpiza)
- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për komunitetin
- Promovimi i adoptimit të kafshëve të braktisura
- Mbështetja dhe kujdesi për kafshët në nevojë

Neni 5 – Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 6 – Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributet e themeluesve dhe të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i saj ekonomik.

Neni 7 – Administrimi

Shoqëria administrohet nga ekipi drejtues i përbërë nga nxënësit, të cilët marrin vendime në lidhje me zhvillimin strategjik, financiar dhe operacional të saj.

Neni 8 – Fitimi

Fitimi i realizuar nga shoqëria përdoret për:

- Zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit
- Mbështetjen e kafshëve të braktisura
- Organizimin e aktiviteteve sociale dhe ndërgjegjësuere
- Mbuluar kostot operative

Neni 9 – Dispozita përfundimtare

Çështjet që nuk parashikohen në këtë statut rregullohen sipas parimeve të përgjithshme të biznesit dhe legjislacionit në fuqi.